



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

**MINISTRIA E MBROJTJES
AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE**



PLANI I INTEGRITETIT

I

AGJENCISË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

2024-2026

Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile

Nr.37, datë 02.02.2024

MIRËNJOHJE

Plani i Integritetit është hartuar nga Grupi i Punës i ngritur në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm z. Haki Çako dhe me asistencën teknike të ofruar nga Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes së Mbretërisë së Norvegjisë (CIDS).

Ky Plan Integriteti është hartuar në zbatim të pikës 5, të urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 516, datë 19.04.2022 për miratimin e “Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes 2022-2025”, si dhe në përbushje të masës A.8.4 dhe A.9.3 të Planit të Veprimit 2020-2023, të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korruptionit miratuar me VKM nr. 247, datë 20.03.2015, të ndryshuar. Këto objektiva parashikojnë përdorimin sistematik të mekanizmit përfocimin e integritetit të nëpunësve publikë, nëpërmjet vlerësimit të riskut të integritetit dhe hartimit, miratimit e zbatimit të planeve të integritetit në të gjitha institucionet e varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes.

Tabela e Përbajtjes

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL	4
Shkurtime dhe akronime.....	5
HYRJE	6
METODOLOGJIA	7
QËLLIMI DHE VIZIONI	8
OBJEKTIVA STRATEGJIKE.....	8
RREZIQET E INTEGRITETIT DHE KORRUPSIONIT.....	9
Fusha e transparencës dhe informimit të publikut	9
Menaxhimi i burimeve njerëzore	9
Auditimi i brendshëm dhe kontrolli	11
Menaxhimi financiar dhe prokurimet publike.....	11
Fusha e inspektimeve	12
Menaxhimi efektiv i riskut të integritetit me fokus në fushat e përgjegjësisë së AKMC-së.....	13
MONITORIMI DHE RAPORTIMI	14
PLANI I VEPRIMIT	15
1. Fusha e transparencës dhe informimit të publikut	16
2. Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore.....	17
3. Menaxhimi financiar dhe prokurimet publike.....	19
4. Fusha e inspektimeve	21
5. Auditimi i brendshëm dhe kontrolli	22
6. Menaxhimi efektiv i riskut të integritetit me fokus në fushat e përgjegjësisë së AKMC-së.....	22

DEKLARATA E INTEGRITETIT INSTITUCIONAL

Përballja efektive me çdo faktor që shkakton shkelje të dispozitave ligjore dhe etikës për Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile është tepër e rëndësishme për arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional, mirëqeverisjen, si dhe për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të fatkeqësive në vend, i cili do të jetë i gatshëm për të përballuar të gjitha sfidat, si ato aktuale edhe ato të ardhshme.

Me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të krijuar nxitet energji e re në kuadër të qeverisjes së riskut të fatkeqësive për të adresuar të gjitha sfidat me të cilat po përballet Shqipëria në mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të popullsisë, mjedisit, aseteve të rëndësishme materiale dhe kulturore, para, gjatë dhe pas fatkeqësive.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka për mision krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive, për të parandaluar, përgatitur, përballuar fatkeqësitetë dhe për t'u rimëkëmbur, nëpërmjet një sistemi të integruar dhe efikas të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë. Për realizimin e misionit të saj, Agjencia ushtron autoritet koordinues, bashkërendues, drejtues, teknik, mbikëqyrës dhe kontrollues, në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitetë dhe mbrojtjen civile.

Një plan integriteti do të ofrojë kornizën konceptuale mbi politikat dhe masat për të parandaluar shkeljet e integritetit të zyrtarëve dhe punonjësve në AKMC, si dhe për monitorimin e efekteve të masave të zbatuara në institucion. Një institucion me integritet të lartë merr vendime dhe vepron sipas parimeve dhe standardeve etike, në të cilin nuk ka asnje tolerancë ndaj qëndrimeve, veprimeve dhe aktiviteteve të punonjësve apo partnerëve të tij që devijojnë prej këtyre parimeve. Si i tillë integriteti nuk mund të ketë vlerë vetëm për nivelet më të larta të qeverisjes dhe administratës, por duhet të përshkojë rrjedhën e aktivitetit të çdo sektori, strukture dhe të gjithë punonjësve për përfaqësimin dinjitoz të Agjencisë në marrëdhënie me institucionet e tjera brenda vendit, si dhe në marrëdhëni dy ose shumëpalëshe jashtë vendit.

Ky Plan Integriteti përfshin risqet e integritetit sipas fushave funksionale të AKMC-së dhe aktivitetet konkrete për adresimin e tyre. Qëllimi tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korruptionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit. Jemi të ndërgjegjshëm se dhënia e shembullit personal dhe menaxhimi i integritetit që nga nivelet më të larta drejtuese, duke ndjekur para së gjithash standarde të larta profesionale dhe etikën, do të sigurojnë një zbatim efektiv të tij nga të gjitha nivelet e institucionit, duke rritur në këtë mënyrë edhe besimin tek ne.

Haki Çako

Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile

Shkurtime dhe akronime

MM	Ministria e Mbrojtjes
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
NATO	North Atlantic Treaty Organization
CIDS	Qendra për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes, Norvegji
DZRFP	Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit
DGKPE	Drejtoria e Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente
DRRKF	Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitë
DBNP	Drejtoria e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve
DETTI	Drejtoria e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit
DFSHM	Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse
SSHKMP	Sektori i Shtypit, Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
PSV	Procedura standarde veprimi
PI	Plan Integriteti
DAP	Departamenti i Administratës Publike

HYRJE

Ndërtimi i integritetit është një aspekt i rëndësishëm i funksionimit të demokracive dhe një shtyllë e rëndësishme e shtetit të së drejtës. Korruzioni ndikon shumë në besimin e publikut, dëmton rëndë efektivitetin e institucioneve dhe cenon legjitimitetin demokratik të tyre. Korruzioni në sektorin e mbrojtjes ka pasoja të rënda, pasi minon aftësitë e mbrojtjes dhe sigurisë së vendit. Ai shkakton shpërdorim të burimeve financiare dhe materiale, prokurime të materialeve dhe pajisjeve të papërshtatshme, keqmenaxhim të burimeve njerëzore, keqpërdorim të aseteve dhe kapaciteteve të mbrojtjes apo dhe ngërç në ndërtimin e një sistemi të integruar dhe efikas të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë.

Orientimi i kulturës institucionale drejt të punuarit me integritet nënkupton që ushtrimi i pushtetit, kompetencat, asetet, burimet dhe fondet në dispozicion të përdoren në mënyrën e duhur. Politikat, procedurat dhe rregullat e miratuarë për këtë qëllim parandalojnë dhe reagojnë ndaj korruzionit, keqpërdorimit të detyrës ose tejkalimit të kompetencave, si dhe ndaj sjelljeve joetike.

Plani i Integritetit është një dokument strategjik dhe një instrument parandalues për forcimin e integritetit të AKMC-së. Gjithashtu, ai është një dokument pune, ku përcaktohen masa konkrete për trajtimin e risqeve të integritetit dhe për të arritur objektivat strategjikë dhe specifikë të institucionit.

Plani i Integritetit është një instrument që rrjedh nga “Plani i Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes 2022-2025” dhe Planit të Veprit 2020-2023 për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korruzionit 2015-2023. Në këtë kuadër Agjencia është në listën e institucioneve publike pararendëse që kanë zhvilluar dhe miratuar një plan integriteti.

Qëllimi i PI është vlerësimi i risqeve të integritetit, të cilat kompromentojnë kapacitetet e AKMC-së për të realizuar objektivat në mënyrë të paanashme dhe të përgjegjshme.

Plani ka identifikuar rreziqe të integritetit në fushat e mëposhtme:

1. Fusha e transparencës dhe informimit të publikut;
2. Fusha e menaxhimit financiar;
3. Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore;
4. Fusha e inspektiveve;
5. Fusha e auditit të brendshëm;
6. Fusha e prokurimeve;
7. Fusha e ushtrimit të detyrave referuar misionit dhe funksionit të agjencisë.

Për të pasur një administratë publike profesionale, me etikë, integritet dhe të angazhuar në përbushjen e detyrave sipas fushës së përgjegjësisë është domosdoshmëri forcimi i integritetit dhe krijimi i mekanizmit të zbatimit, të monitorimit dhe vlerësimit për të matur progresin e arritur.

Plani i Integritetit parashikon të prodhojë një nxitje re dhe shtysë të mëtejshme të përpjekjeve të deritanishme, duke gjeneruar aktivitete dhe praktika të reja të cilat synojnë përmirësimin e mekanizmave të menaxhimit në tërësi. Në këtë kuadër, menaxhimi i integritetit institucional ka për qëllim jo vetëm garantimin e zbatimit me korrektesë të kuadrit ligjor dhe të rregullave në fuqi, por edhe planifikimin e masave që përmirësojnë kapacitetet teknike të punonjësve të administratës për zbatimin e tyre. Përgjegjësitë kryesore për administrimin e këtij procesi u takojnë organeve ekzekutive në agjenci, si edhe strukturave përbërëse të saj.

METODOLOGJIA

Plani është hartuar duke u mbështetur në metodologjinë e vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, të miratuar nga Koordinatori Kombëtar Kundër Korruptionit, të Pyetësorit të Vetëvlerësimit të Ndërtimit të Integritetit të NATO-s dhe të Indeksit Qeveritar të Integritetit të Mbrojtjes të Transparency International dhe të Planit të Integritetit të Ministrisë së Mbrojtjes.

Zhvillimi i Planit të Integritetit kaloi nëpër disa fazë, duke filluar me (i) krijimin e procesit përmes ngritjes së grupit të punës, i përbërë nga zyrtarë të drejtorive të AKMC-së dhe me drejtimin e Drejtorisë së Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit, (ii) përgatitja e programit të punës së këtij grupi, (iii) kryerjen e vlerësimit filletar të rrezikut të korruptionit dhe integritetit në sektorë të veçantë, (iv) shqyrtimi dhe analizimi i dokumentacionit të mbledhur lidhur me vlerësimin e ekspozimit dhe rezistencës së institucionit ndaj risqeve; (v) hartimin e masave dhe aktiviteteve për adresimin e risqeve.

PI për Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile u hartua gjatë periudhës korrik-dhjetor 2023 dhe është dokumenti i parë i hartuar nga AKMC për të kontribuar në parandalimin dhe luftën kundër rreziqeve të mundshme të korruptionit në këtë institucion. Për hartimin e këtij dokumenti u angazhuan përfaqësues nga të gjitha drejtoritë e agjencisë, referuar urdhrit si:

Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit (DZRFP);

Drejtoria e Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente (DGKPE);

Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitetë (DRRKF);

Drejtoria e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve (DBNP);

Drejtoria e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit (DETTI);

Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (DFSHM), me qëllim analizimin, vlerësimin dhe trajtimin e risqeve.

Procesi përfundoi me konsultimin e planit, miratimin e tij zyrtar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKMC-së dhe publikimin e tij.

QËLLIMI DHE VIZIONI

Qëllimi kryesor i Planit të Integritetit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile 2024-2026 është të forcojë integritetin dhe kulturën kundër korruptionit në sektorin e mbrojtjes civile në Shqipëri.

Vizioni i këtij plani është një sektor i mbrojtjes civile që ruan integritetin dhe refuzon korruptionin, duke institucionalizuar standardet dhe parimet më të larta të mirëqeverisjes.

OBJEKTIVA STRATEGJIKE

Për realizimin e qëllimit dhe vizionit, Plani i Integritetit i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile vendos disa objektiva strategjikë të cilët synohet të arrihen përmes zbatimit të aktiviteteve të përcaktuara në këtë plan. Plani evidenton sfidat reale me të cilat agjencia ndeshet në aspekte të veçanta të integritetit dhe siguron angazhim të vazhdueshëm të saj për përballimin e tyre me qëllim final garantimin e një qeverisjeje të mirë dhe një zhvillimi të qëndrueshëm. Gjithashtu, objektivat strategjikë kanë shërbyer si orientim për të identifikuar aktivitete dhe masa të përshtatshme dhe treguesit për matjen e tyre.

Objektivat strategjikë reflektojnë gjithashtu objektivat e politikës së mbrojtjes (Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes, Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitet), Strategjisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore 2020-2024 të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe objektivat e Strategjisë Ndërsektorale për Luftën Kundër Korruptionit. Në këtë mënyrë, Plani i Integritetit të AKMC-së siguron përfshirjen e konceptit të integritetit në aspektet kryesore të punës së AKMC-së dhe strukturave të saj.

Nga sa më sipër, objektivat strategjike të Planit të Integritetit të AKMC-së 2024-2026 janë:

1. Rritja e transparencës së AKMC-së dhe informimit të publikut;
2. Menaxhimi efektiv i riskut të integritetit me fokus në fushat e përgjegjësisë së AKMC-së;
3. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në të gjitha nivelet dhe funksionet në agjenci;
4. Forcimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm;
5. Përmirësimi i menaxhimit financiar dhe prokurorimet publike;
6. Përmirësimi i procedurave në fushën e inspektimeve;

RREZIQET E INTEGRITETIT DHE KORRUPSIONIT

Fusha e transparencës dhe informimit të publikut

Transperanca dhe informimi është një element thelbësor, ku subjektet dhe publiku duhet të njihen me procedura të sakta të cilat duhet të janë publike, me ndryshime legislacioni dhe informim mbi aktivitetet e institucionit.

Statusi aktual

Nga analiza përbajtësore e faqes zyrtare të internetit të AKMC-së, vihet re se publikohen të dhëna dhe informacion me karakter informues. Për të rritur besimin e publikut mbi transparencën e institucionit duhet të publikohen gjithashtu edhe informacione dhe dokumente që lidhen me mekanizmat monitorues, të kontrollit dhe llogaridhëns, siç mund të janë: raporte të auditimeve të jashtme, raportin vjetor të auditimit të brendshëm në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënavë personale, projekte, kontrata publike, procesverbale, raporti vjetor i transparencës. Koordinatori për të Drejtën e Informimit është caktuar me akt të titularit dhe të dhënat e tij janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit. Menaxhimi i informacionit dhe dokumentacionit ka staf të informuar dhe më aftësitet e duhura dhe komunikim efektiv që respekton afatet kohore në sigurimin e informacionit.

Programi i Transparencës përfaqëson një instrument që kontribuon për transparencën dhe përgjegjshmërinë e institucionit, një detyrim i përcaktuar në ligjin për mbrojtjen e së drejtës për informim. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile e ka publikuar Programin e Transparencës në faqen zyrtare të saj. Informacioni është i plotë dhe lehtësish i aksesueshëm, për të shmangur mungesën e trasparencës me publikun dhe grupet e interesuara.

Duhet të përditësohet rregullisht Programi i Transparencës së AKMC-së;

Treguesi i përgjithshëm matës

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: “*Përmirësim i procesit të informimit të publikut nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës, llogaridhënieve dhe informimit të publikut*”.

Menaxhimi i burimeve njerëzore

Menaxhimi i burimeve njerëzore është një pjesë e rëndësishme dhe e domosdoshme për sektorin e mbrojtjes civile. Për çdo institucion që bën pjesë në sektorin e mbrojtjes, menaxhimi efektiv i burimeve të tij, qofshin këto burime njerëzore apo burime të tjera, duhet të përfaqësojë filozofinë e përgjithshme institucionale mbi bazën e së cilës duhet të hartohen objektivat afatgjatë dhe afatmesëm, politikat dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera. Për të pasur menaxhim të suksesshëm të burimeve njerëzore është e nevojshme që procesi të përfshijë të katër funksionet menaxheriale, që janë: planifikimi, organizimi, drejtimi dhe monitorimi. Gjithashtu, duhet që ky proces të shoqërohet nga një nivel i lartë i transparencës dhe llogaridhënieve.

Statusi aktual

Burimet njerëzore janë elementi kryesor i sistemit të mbrojtjes civile dhe menaxhimi efektiv i tyre ka një ndikim shumë të rëndësishëm në këtë sistem. Mirëfunksionimi i administratës ka nevojë për linja të qarta hierarkike, manual të proceseve të punës për çdo njësi të institucionit, plan vjetor pune, si dhe për promovimin e standardeve dhe parimeve të administratës publike. Nga shqyrtimi i kuadrit të brendshëm rregullator të institucionit duhet që të gjitha strukturat/njësitë e institucionit të kenë dokumente që rregullojnë në detaje proceset e punës të realizuara nga çdo strukturë/funksion i institucionit, pasi në të kundërt mund të rezultojë ulja e nivelit të cilësisë së punës të një strukture. Mosplotësimi i pozicioneve të punës me staf të përhershëm mund të sjellë vonesa në realizimin e proceseve të punës si dhe mund të ndikojë në efektivitetin e këtyre proceseve. Në lidhje me Kodin e Etikës duhet të bëhen trajnime të brendshme me punonjësit, mbi përbajtjen e tij apo zgjidhjen e dilemave sipas përcaktimeve të këtij kodi.

AKMC ka një organikë të miratuar me 106 punonjës. Institucioni është përmbushur me staf të kualifikuar në tërësinë e tij. Ka të ngritur njësinë e sinjalizimit brenda institucionit, e cila njeh dhe zbaton ligjin dhe procedurat e sinjalizimit. Institucioni duhet të përcaktojë Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik në institucion, si dhe njësinë përgjegjëse për paandalimin e konfliktit të interesit, si role esenciale për ndërtimin e integritetit.

Rekrutimi i stafit të Agjencisë bëhet në bazë të procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për statusin e nepunësit civil”, ku specifisht thuhet se pranimi në shërbim civil bëhen në bazë të shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit dhe kryhet nepërmjet një procesi përzgjedhës transparent e të drejtë. Procesi përzgjedhës bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve nepërmjet një konkuri kombëtar, që përfshin një testim të shkruar, një testim me gojë dhe çdo formë tjeter të përshtatshme të verifikimit të aftësive, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatit. Roli i AKMC-së në procesin e rekrutimit të stafit është i vogël, pasi i gjithë procesi administrohet nga Departamenti i Administratës Publike.

Dokumentacioni në lidhje me dosjet personale të punonjësve të Agjencisë administrohet nga njësia e burimeve njerëzore në hard copy, për të cilët janë të qarta rregullat përményrën e administrimit të të dhënave personale. Kategoria ekzekutive e mesme drejtuese ka filluar procesin e pajisjes me certifikatën e sigurisë, për raste kur mund të ketë informacion të klasifikuar.

Përshkrimet e punës janë të hartuara për çdo pozicion. Në përshkrimet e punës nuk janë të reflektuara të gjitha detyrat që kryejnë punonjësit. Detyrat që burojnë nga ligje specifike të tillë, si p. sh.: ligji “Për të drejtën e informimit”, ligji “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligji “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” apo Strategjia Ndërsektoriale në Luftën kundër Korruptionit, ndonëse në disa raste si për ligjin “Për të drejtën e informimit” janë të rregulluara me akte të brendshme, nuk janë të reflektuara në përshkrimet e punës. Zakonisht kryerja e këtyre detyrave shtesë kryhet nepërmjet urdhavrave të eprorit direkt. Prandaj është e nevojshme që përshkrimet e punës jo vetëm të rishikohen, duke reflektuar të gjitha detyrat shtesë që burojnë nga ligje të tjera, por dhe të jenë transparente. Krahas organigramës së institucionit duhet të publikohet dhe misioni apo detyrat përkatëse të çdo drejtorie.

Vlerësimi i performancës në punë në AKMC kryhet njëherë në gjashtë muaj, në përputhje me formatet e miratuar nga Departamenti i Administratës Publike për personelin me status të nepunësit civil.

Një komponent shumë i rëndësishëm i zhvillimit të burimeve njerëzore është trajnimi i vazhdueshëm i tyre. Nga vlerësimi i situatës dhe indikatorëve të këtij komponenti rezulton se institucioni ka kryer një sërë trajnimesh, por duhet hartuar dhe përmirësuar (i) sistemi i analizës në lidhje me nevojat për trajnim, me qëllim përcaktimin e nevojave reale të punonjësve për trajnime, (ii) procedura e raportimit dhe shkëmbimit të informacionit në lidhje me pjesëmarrjen e stafit në trajnime, duke bashkëndarë njohuritë e fituara me kolegët e tjerë, me qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive apo të shkëmbimit të përvojave nga praktika, (iii) sistemi i feedback-ut për të mundësuar vlerësimin e trajnimeve.

Treguesi i përgjithshëm matës

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: “*Përmirësim i procesit të menaxhimit të burimeve njerëzore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënieve*”.

Auditimi i brendshëm dhe kontrolli

Roli i auditimit të brendshëm është të ofrojë siguri për nivelin e lartë drejtues të institucionit që procesi i kontrollit është objektiv dhe i pavarur. Auditimi i brendshëm ndihmon institucionin për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, si dhe shërben për të vlerësuar e përmirësuar menaxhimin e riskut. Auditimi shërben për të identifikuar risqet në një institucion, si dhe kontribuon në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të riskut, vlerësimin e kontolleve të cilat adresojnë risqe, si dhe inkurajon kontrolllet efektive dhe eficiente.

Statusi aktual

Në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, auditimi i brendshëm kryhet nga Sektori i Auditit. Procesi i auditimit të brendshëm është një proces tërësisht i pavarur në mënyrë organizative dhe funksionale dhe raportimi bëhet pranë titullarit të institucionit.

Menaxhimi financiar dhe prokurimet publike

Reziquet e integritetit mund të hasen në çdo fazë të procesit të prokurimit, nga vlerësimi i nevojave, analiza e tregut, planifikimi, buxhetimi, draftimi i specifikimeve teknike, finalizimi i kontratës e deri te mbikëqyrja e implementimit të kontratës. Duke qenë se reziquet e integritetit ekzistojnë gjatë gjithë procesit të prokurimit publik, është e nevojshme që të aplikohet një metodë gjithëpërfshirëse për të parandaluar korruptionin dhe për të reduktuar tërësisht rreziqet e integritetit. Duhet që kjo qasje gjithëpërfshirëse të jetë e bazuar në parime të tillë, si: transparenca, pjesëmarrje dhe akses i barabartë për të gjithë operatorët ekonomik, prokurim elektronik, mbikëqyrje dhe kontroll.

Statusi aktual

Prokurimet publike janë një nga fushat ku probabiliteti për korruption është i lartë. Lufta kundër korruptionit dhe forcimi i integritetit në procesin e prokurimit publik nuk mund të realizohen

vetëm nëpërmjet miratimit të një kuadri ligjor dhe rregullator të avancuar. Për të shhangur korrupsionin, por dhe sjelljet joetike që mund të ndodhin gjatë fazave të ndryshme të procesit të prokurimit publik, është e nevojshme dhe e domosdoshme që niveli i transparencës të jetë maksimal. Përveç forcimit të transparencës, një element tjetër i rëndësishëm për prokurimet publike është mbikëqyrja dhe kontrolli i rregullt me qëllim garantimin e një procesi të drejtë. Punonjësit e përfshire në proceset e prokurimeve publike janë të ekspozuar ndaj një niveli të lartë risku, duke filluar që nga procesi i draftimit të specifikimeve teknike e deri te kriteret për pjesëmarrje në tendera. Për shkak të riskut të lartë që paraqet ky sektor, Agjencia duhet të mundësojë rotacion të shpeshtë të stafit në sektorët me risk të lartë, siç është dhe ai i prokurimeve publike. Është i nevojshëm miratimi i disa rregullave specifike për kryerjen e këtij rotacioni. Trajnimi i stafit, pjesë e grupit të njësisë së prokurorimit dhe komisionit të vlerësimit të ofertave, përbën një domosdoshmëri në fushën e prokurimeve publike, pasi mungesa e njojurive krijon rishkak të lartë për cënimin e integritetit të institucionit.

Regjistri i parashikimeve dhe regjistri i realizimeve është transparent dhe i përditësuar. Një informacion tjetër i nevojshëm është dhe ai që ka të bëjë me kontratat e lidhura nga Agjencia. Të gjitha të dhënat mbi palët që kanë lidhur kontratën, shumën dhe afatin duhet të jetë të publikuara në mënyrë proaktive.

Përveç prokurimeve një fushë tjetër e rëndësishme është dhe menaxhimi financiar. Për sa i përket kuadrit ligjor që rregullon financat e institucionit, mund të thuhet që është në përputhje të plotë me standarde e Bashkimit Evropian. Është e domosdoshme që punonjësit e financës të kenë nivelin e duhur të njojurive dhe trajnimet e nevojshme, për sa i përket buxhetit për shpenzime korrente, për investime, raportet e monitorimit financiar etj. Risqe të tjera që mund të shfaqen në fushën e menaxhimit financiar mund të jenë dhe mosbatimi i kontratave të lidhura sipas grafikut të parashikuar, duke krijuar në këtë mënyrë hendeqe financiare. Gjithashtu, ndryshimi i prioriteteve institucionale mund të çojë në mos rakordim ndërmjet planifikimit dhe ekzekutimit të buxhetit të institucionit, duke krijuar problematika për institucionin.

Treguesi i përgjithshëm matës

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: “*Transparencë proaktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik*”.

Fusha e inspektimeve

Sektori i inspektimit ka për mision inspektimin e institucioneve dhe strukturave shtetërore dhe subjekteve private, për zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes civile. Realizon ndjekjen e procedurave për evidentimin e listës së subjekteve publike dhe private që kanë detyrim marjen e masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësítë dhe mbrojtjen civile, si dhe çdo detyrim tjetër ndaj ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”. Reziqet e integritetit mund të hasen në çdo fazë të kontrollit dhe inspektimit të ndërmarrë nga AKMC-ja. Planifikimi paraprak i inspektimeve vjetore dhe periodike si dhe përcaktimi i qartë i procedurave për inspektime nga ana e agjencisë përforcon dhe nxit zbatimin e dispozitave ligjore. Procesi i inspektimit dhe kontrollit duhet të jetë i bazuar në metodologjinë e programit në sistemin “e-inspektimi”. Duke qenë se reziqet e integritetit ekzistojnë gjatë gjithë procesit të inspektimit, është e nevojshme që të

aplikohet një metodë gjithëpërfsirëse për të parandaluar korruptionin dhe për të reduktuar tërësisht rreziqet e integritetit.

Statusi aktual

Në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, inspektimi kryhet nga Sektori i Inspektimit, si sektor me varësi të drejtëpërdrejtë te titullari i institucionit. AKMC-ja kryen inspektime pranë institucioneve/subjekteve për zbatueshmérinë e detyrimeve të përcaktuara në legjislacion. Është kryer hartimi i akteve procedurale të inspektimit dhe miratimi i tyre nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të AKMC-së. Ka një program inspektimi të hartuar nga sektori i inspektimeve, në përputhje me Metodologjinë e programit në sistemin “e-inspektimi”, si dhe janë marrë masa për regjistrimin dhe sigurimin e aksesit në portalin “e-inspektimi”. Është domosdoshmëri ushtrimi i inspektimeve në mënyrë periodike dhe marrja e masave, me qëllim forcimin dhe zbatueshmérinë e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”.

Treguesi i përgjithshëm matës

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: “*Përmirësim i procesit të inspektimit nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe procedurave transparente*”.

Menaxhimi efektiv i riskut të integritetit me fokus në fushat e përgjegjësisë së AKMC-së

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile kryen aktivitetin e saj referuar ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, ligj që rregullon funksionimin e sistemit të mbrojtjes civile, duke përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve dhe të strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile funksionon sipas strukturës së miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 27, datë 03.02.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile” dhe drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili, është autoriteti më i lartë administrativ, që organizon e drejton veprimtarinë e Agjencisë dhe përgjigjet drejtpërdrejt përrapa ministrit, për realizimin e politikave dhe të objektivave të përcaktuara.

Statusi aktual

Realizimi i misionit dhe objektivave të agjencisë realizohet nga drejtoritë respektive, të cilat ushtronjnë detyrat sipas fushës së përgjegjësisë, referuar ligjit, akteve ligjore dhe nënligjore. Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe e Parandalimit (DZRFP) ka për mision të garantojë bashkërendimin ndërinstitucional, për hartimin e programeve dhe të strategjive në fushën e mbrojtjes civile, vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë dhe planet e emergjencave civile, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Drejtoria e Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente (DGKPE) ka për mision të garantojë gatishmérinë dhe koordinimin e strukturave të mbrojtjes civile, për menaxhimin e informacionit mbi një kërcënëm të afërt apo rrezik të evidentuar dhe vendosjen në veprim të kapaciteteve të nevojshme që disponohen, për përgjigjen e menjëhershme dhe përballimin e situatës së emergjencës civile apo ndihmës humanitare. Drejtoria e Rehabilitimit, Rimëkëmbjes dhe Kompensimit nga Fatkeqësitetë (DRRKF) ka për mision, marrjen

e masave strukturore për parandalimin, gatishmërinë, përballimin, rehabilitimin e rimëkëmbjen e komunitetit/shoqërisë të prekur nga një fatkeqësi, monitorimin e realizimit të masave strukturore për shëmangien apo zvogëlimin e ndikimit të rreziqeve, si dhe krijimin e bazës së të dhënave kombëtare të humbeje nga fatkeqësitet, vlerësimin e tyre dhe kompensimin. Drejtoria e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve (DBNP) ka si mision realizimin (jetësimin) e bashkëpunimit me agjencitë partnere dhe organizatat ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes civile dhe të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitet, ku përfshihet edhe hartimi i projekteve në fushën e mbrojtjes civile si edhe programimi dhe implementimi i mbështetjes financiare nga donatorë dhe organizma të huaja dhe vendase. Drejtoria e Edukit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit (DETTI), ka për mision të garantojë trajnimin e vazhdueshëm të strukturave shtetërore, subjekteve private dhe vullnetarëve, edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut përritjen e aftësive për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitet dhe mbrojtjen civile, si dhe zbatimin dhe miradministrimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, përritjen e objektivave të Agjencisë. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse (DFSHM) ka për mision të sigurojë miradministrimin e burimeve financiare, njerëzore, aseteve dhe shërbimeve, si dhe ofrimin e këshillimit ligjor, plotësimin e nevojave përmallra e shërbimeve të aparatit të institucionit, me qëllim sigurimin e kushteve për realizimin e misionit, ekzekutimin e kompetencave dhe arritjen e objektivave të Agjencisë.

Treguesi i përgjithshëm matës

Treguesi i përgjithshëm matës përkufizohet përmirësimi i proceseve të punës nëpërmjet forcimit të kapaciteteve me synim forcimin e integritetit të stafit të AKMC-së”.

MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Në fillim të çdo viti duhet të realizohet procesi i monitorimit të këtij Plani, proces i cili do të pasqyrojë kryerjen e aktiviteteve nga ana e administratës, përgjegjëse përzgjidhës së zbatimin e masave të miratuara në të. Secila nga drejtoritë përkatëse të AKMC-së do të ketë angazhimin e saj në përmbrushjen e masave të parashikuara në Planin e Vepërimit, si dhe do të caktojë një punonjës përgjegjës për procesin e monitorimit dhe vlerësimit. Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë efektive, nëse kanë nxjerrë në pah ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioriteteve të risqeve (planit të veprimit), si dhe nxjerrjen e mësimave për planifikim më të mirë në të ardhmen.

Raportimi eshtë një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e planit të integritetit përisqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces do të ndiqet nga personi përgjegjës apo një grup përgjegjës pune si përfaqësues të drejtoreve respektive, i caktuar nga titullari i institucionit. Personi përgjegjës/grupi i punës do të koordinojë mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e raportimeve që do të përcillen nga drejtoritë/strukturat e ngarkuara në përmbrushje të objektivave dhe masave përkatëse. Frekuanca minimale e raportimit eshtë brenda një periudhe gjashëmujore. Raportimi i lejon titullarit të ndërmarrë në kohë masa përmirësuese, në rast se zbatimi i ndonjë mase të caktuar ka sjellë vështirësi apo vonesa.

Me synim forcimin e integritetit dhe reduktimin e hapësirave për korruption si dhe bazuar në vlerësimin e problematikave të ndeshura gjatë implementimit të planit të integritetit, do të formulohen rekomandimet përkatëse për masat e parashikuara në këtë dokument.

Në përfundim të periudhës së zbatimit të Planit të Integritetit, do të hartohet jo vetëm raporti përfundimtar, por do të identifikohen dhe masat e nevojshme që duhen ndërmarrë në të gjithë sektorin e mbrojtjes civile, me synim fuqizimin e integritetit.

PLANI I VEPRIMIT

Plani i Veprimit është një mjet plotësues i politikave dhe kornizës rregullatore për përmirësimin dhe forcimin e integritetit institucional. Ai përbledh tërësinë e masave të kontrollit që adresojnë risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit të vlerësuara për çdo fushë të përgjegjësisë së Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

1. Fusha e transparencës dhe informimit të publikut

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është “Përmirësim i procesit të informimit të publikut nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rritjes së transparencës, llogaridhënieve dhe informimit të publikut”.

Nr.	RISKU	MASA QË DO TË MERRET	NJËSIA PËRGJEGJËSE	AFATI	AKTIVITET
1.	Mungesa e publikimit në faqen zyrtare të Agjencisë i mekanizmave monitorues; raporteve të auditit; i raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit të agjencisë, si dhe dokumenteve me tregues performance.	Faqja zyrtare e AKMNC e përditësuar me raporte të auditit; zbatimit të buxhetit; informacion mbi procedurat e prokurimit.	DFSHM; Sektori i Auditit; SSHKMP.	Prill 2024	Publikimi i reportit vjetor të auditimit në përputhje me ligjin e mbrojtjes së të dhënave personale; informacion mbi procedurat e prokurimit dhe zbatimit të buxhetit.
2.	Mungesa e një sistemi elektronik të shpërndarjes së informacionit.	Krijimi i një sistemi për shpërndarjen e informacionit (në rastet e emgjencave, do të jetë baza për informimin sipas kanaleve zyrtare).	Drejtori i AKMC-së	2024-2025	Zhvillimi i takimeve, seminareve dhe metodave interactive; Krijimi i një draft-ide.
3.	Mungesa e njësisë përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit.	Ngritura e njësisë përgjegjëse për parandalimin e	Sektori i burimeve njerëzore të institucionit.	Janar – Shkurt 2024	-Urdhri për ngritjen e njësisë i miratuar nga Titullari i Institucionit. -Njohja e personelit me rolin e njësisë

	konfliktit të interest në AKMC.	-MM -ILDKPKI	përgjegjëse dhe dispozitat ligjore. -Krijimi i regjistrat të komfliktit të interesave.
4.	Mospublikimi i informacionit për procedurat që duhen ndjekur për të bëré një kërkësë pér informim pér qytetarët, përfitues të kompensimeve, pér vitet pér të cilat është përgjegjëse AKMC.	Publikimi i informacionit pér procedurat që duhet ndjekur pér të bëré një kërkësë informimi.	DRRKF SSHKMP Mars 2024

2. Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore

Treguesi i përgjithshëm matës

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: “*Përmirësim i procesit të menaxhimit i burimeve njerëzore nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe rriftjes së transparencës dhe llogaridhënieς*”.

Nr.	RISKU	MASA QË DO TË MERRET	NJËSIA PËRGJEGJËSE	AFATI	AKTIVITETET
1.	Plotësimi i procedurave standarde të 1. veprimit.	Hartimi dhe miratimi i procedurave standarde të veprimit pér secilin proces pune në agjenci.	Drejtori të AKMC	Shkurt 2024	Rishikimi i procedurave ekzistuese; Draftimi i procedurave standarde të veprimit pér njësi të që mungojnë.

<p>2.</p> <p>Mungesa e trajnimit të vazhdueshëm në lidhje me antikorrupsionin dhe integritetin për të gjithë personelin.</p>	<p>Përfshirja e trajnimit për antikorrupsionin dhe integritetin, në planin vjetor të trajimeve.</p> <ul style="list-style-type: none"> -Sektori i burimeve njerëzore; -Shkolla Shqiptare e Administratës Publike; -ILDKPKI, -DAP 	<p>Bashkëpunim /koordinim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, ILDKPKI, DAP, për ofrimin e kurrikulave të përshtatshme të trajnimit, në bazë të nevojave të institucionit, kalendarit të trajnimeve, etj.</p> <p>Në vijim për vitin 2024</p>
<p>3.</p> <p>Mungesa e evidentimit të kërkesave të nepunësit si dhe propozimeve të zyrtarit raportues për trajnim e mundësi për zhvillim profesional.</p>	<p>Hartimi i planit vjetor për trajnine.</p>	<p>Evidentimi i nevojave për trajnim dhe zhvillim të personelit nga të gjithë zyrtarët rapportues në seksionin e posacem të formularit të vlerësimit të performances në punë.</p> <p>-Vlerësimi i nevojave për trajnim sipas fushave të ushtimit të detyrave.</p> <p>-Plani vjetor për trajnimin e personelit te AKMC, i miratuar nga Titullari i Institucionit.</p> <p>Janar-Shkurt 2024</p> <p>-Zyrtarët Raportues të të gjithë strukturave të AKMC.</p>

4.	<p>Njohuri të kufizuara të stafit mbi ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, për të drejtën e informimit, ligji për konfliktin e interesit.</p>	<p>Angazhimi për zhvillimin trajnimit dhe përfshirjen e tematikave në planin vjetor të trajimeve.</p>	<p>-Sektori i burimeve njerëzore; -Shkolla Shqiptare e Administratës Publike; -DAP</p>	<p>Bashkëpunim /koordinim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, DAP, për ofrimin e trajnimeve periodike të punonjësve, sipas fushave të ushtrimit të detyrave funksionale, etj.</p>
----	--	---	--	---

3. Menaxhimi financiar dhe prokurimet publike

Treguesi i përgjithshëm matës
Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: “*Transparencë proaktive e përmirësuar për të gjithë fazat e procesit të prokurimit publik*”.

Nr.	RISIKU	MASA QË DO TË MERRET	NJËSIA PËRGJEGJËSE	AFATI	AKTIVITET
1.	Mungesa e transparencës për të gjithë dokumentacionin e hartuar për procesin e prokurimit publik.	Përditësimi i programit të transparencës.	Sektori i prokurimit dhe mariëdhënieve kontraktuale; SSHKMP.	Mars 2024	Publikimi në programin e transparencës i regjistrat të parashikimeve dhe regjistri i realizimeve të prokurimeve publike.

			Publikimi në programin e transparencës i kontratave të lidhura me operatorë të ndryshëm, si dhe publikimi i donacioneve (nëse këtë tillë).
2.	Mungesë e publikimit të kontratave të lidhura nga Agjencia.	Sektori i prokurimit dhe marrëdhënieve kontraktuale; SSSHKMP.	2024-2025
3.	Mungesë e një mirë planifikimi të procedurave në regjistrin e parashikimit të prokurorimeve publike, e cila shkakton ndryshime të shpeshta gjatë vitit.	Sektori i prokurimit dhe marrëdhënieve kontraktuale; Drejtori i AKMC.	Zhvillim i takimeve për njojen me procedurën; Planifikim i mirë i procesit.
4.	Mungesa e një mirëorganizimi dhe funksionalizimi i punës në kohë mes drejtorive të AKMC.	Sektori i prokurimit dhe marrëdhënieve kontraktuale; Drejtori i AKMC.	Takim mes drejtorive dhë planifikim i mirë me çëllim realizimin e detyrave sipas kalendarit.
5.	Mosplanifikimi i nevojave dhë shërbimeve sipas fushës së përgjegjësisë së çdo drejtorie, për t'u përfshire në regjistrin e parashikimeve të prokurorimeve	Sektori i prokurimit dhe marrëdhënieve kontraktuale;	Krijimi i një grupi pane; Takime, diskutime për planifikimin dhe pasqyrimin e nevojave dhë shërbimeve.

publike pas miratimit të buxhetit të vitit pasardhës.	Drejtorië e AKMC.
--	-------------------

4. Fusha e inspektimeve Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: “Përmirësim i procesit të inspektimit nëpërmjet forcimit të kapaciteteve dhe procedurave transparente”.

Nr.	RISKU	MASA QË DO TË MERRIT	NJËSIA PËRGJEGJËSE	AFTATI	AKTIVITETET
1.	Mungesa e trajnimeve mbi procesin e inspektimit të strukturave shtetërore dhe subjekteve private, për zbatimin e dispozitive ligjore e nënligjore në fushën e mbrojtjes civile.	Përfshirja e trajnimeve të inspektoreve dhe strukturave përgjegjëse mbi procedurat e inspektimit.	Sektori i Inspektimit	Qershori 2024	Organizimi dhe pjesëmarrja në trajnime specifike në lidhje me procedurat e inspektimit.
2.	Përmirësimi i sistemit të raportimit.	Krijimi i një metodike eficiente përmenyrën e raportimit.	Sektori i Inspektimit	2024	Konsultime me palët e interesit; Krijimi një procesi standard.
3.	Kryerja e inspektimeve periodike.	Inspektime sipas fushës së përgjegjësisë.	Sektori i Inspektimit	2024	Kalendari për kryerjen e inspektimeve.

5. Auditimi i brendshëm dhe kontrolli

Treguesi i përgjithshëm matës

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: “*Forcimi i rolit të Sektorit të Auditimit të brendshëm, kryerja e auditimeve përkatese me synim forcimin e integritetit të stafit të AKMC-së*”.

Nr.	RISKU	MASA QË DO TË MERRIT	NJËSIA PËRGJEGJËSE	AFATI	AKTIVITETET
1.	Mungesë e vlerësimit të performancës dhe efektivitetit të sistemeve e të kontolleve.	Vlerësimi i kryer.	Sektori i Auditimit	2024	Trajinime mbi fushën e auditimit; Kryerja e vlerësimeve sipas objektivave.
2.	Mungesë e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të AKMC-së.	Rekomandime dhe ndjekja e tyre.	Sektori i Auditimit	2024	Nxjerja e rekomandimeve pas zhvillimit të kontolleve Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

6. Menaxhimi efektiv i riskut të integritetit me fokus në fushat e përgjegjësisë së AKMC-së

Treguesi i përgjithshëm matës

Treguesi i përgjithshëm matës për këtë fushë është: “*Përmirësim i proceseve të punës nëpërmjet forcimit të kapaciteve me synim forcimin e integritetit të stafit të AKMC-së*”.

Nr.	RISKU	MASA QË DO TË MERRET	NJËSIA PËRGJEGJËSE	AFATI	AKTIVITET
1.	Marrëveshje jo të konsoliduara të bashkëpunimit rajonal për sistemet e monitorimit dhe paralajmërimit të hershëm ndërkuftar.	Lidhja e marrëveshjeve dhe zbatimi i tyre.	DBNP; DGKPE.	Dhjetor 2025	Sipas përcaktimit në cdo marrëveshje.
2.	Mungese e rrjetit kombëtar të vullnetarizmit.	Krijimi i një rjeti kombëtar të vullnetarizmit.	DETTI; Drejtoritë e AKMC.	2024-2026	Takime përritjen e ndërgjegjësimit; Hartimi i procedurave standarde; Trajinime dhe shpërndarje të praktikave.
3.	Moszbatimi i plotë i numrit të unifikuar të emergjencës civile 112 dhe numrit jeshil, në të gjithë territorin e Shqipërisë.	Zbatimi i numrit të unifikuar të emergjencës civile 112 dhe numrit jeshil.	DGKPE; Drejtoritë e AKMC.	2024-2025	Takime/aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit;
4.	Mungesë e teknologjisë moderne e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm.	Blerja e një softueri që do të ndihmojë sistemin e paralajmërimit të hershëm.	DGKPE; DFSHM.	Dhjetor 2025	Procedurat e nevojshme për realizimin e blerjes; Gjetja e donatorëve.
5.	Mungesa e trajnimeve të strukturave të mbrojtjes civile dhe vullnetarëve.	Zhvillimi i trajnimeve periodike.	DETTI; Drejtoritë e AKMC.	Dhjetor 2024	Plan i miratuar i trajnimeve; Hartimi i një kalendari vjetor

				trajnimesh; Takime, diskutime,ëorkshore.
6.	Raportim dhe shkëmbim informacioni për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësítë dhe mbrojtjen civile jokoherent dhe i sakte (në të gjithë strukturat e sistemit të mbrojtjes civile, palët e interesit).	Percaktimi i afateve, kritereve dhe formatit. Monitorimi procedurave standarde.	DZRFP Tetor 2025	Konsultime me palët e interesit; Krijimi një procesi standard.
7.	Nivel i ulet i njohurive dhe ndërgjegjësimi në nivel kombëtar për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësítë dhe mbrojtjen civile.	Rritja e ndërgjegjësimit për shoqërinë civile, grupet e marginalizuara dhe komunitetin.	DZRFP; DETTI; DGKPE.	Zhvillimi i takimeve ndërgjegjësuese, workshopë, aktivitete.
8.	Vështirësi në evidentimin dhe raportimin e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësítë dhe menaxhimit të informacionit të riskut.	Një sistem përmbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësítë.	DRRKF Dhjetor 2024	Konsultimet e nevojshme për realizimin e sistemit.
9.	Mungesë e procedurave standarde për realizimin e “host nation support”.	Miratimi i procedurave standarde, të unifikuara me BE.	DGKPE; DBNP. Dhjetor 2024 - Prill 2025	Trajnine mbi host nation support. Hartimi i dokumentacionit të nevojshëm të veprimit.

10.	Dixhitalizimi i protokoll-arkivës	Sistem për evidencimin e çdo dokumenti për një gjurmim më eficient dhe transparent.	DFSHM	2025	Krijimi i databazës historike të praktikave shkresore dhe dixhitalizimi i tyre.
-----	--	---	-------	------	---